



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Mësuesi për Arsim Parashkollor”

ofruar nga

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Edi Puka

Dr. Shqipe Shyti

Prill 2024

Tabela Përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në
“Mësuesi për Arsim Parashkollor”

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Mësuesi për Arsim Parashkollor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 251, datë 02.06.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr 13 dt 08.04.2020 Miratuar nga MAS me shkresë Nr. 2481/1, dt 20.05.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 385, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 81, datë 05.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 12 PAE/ -10 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 15 studentë 2020-2021 20 studentë 2021-2022 27 studentë 2022-2023 65 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor ofrohet nga Universiteti Albanian University, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.

Universiteti Albanian University përbëhet nga:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

Universiteti Albanian University është institucioni privat i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë që ofron Nivelet 6, 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Universiteti Albanian University, pra ofron programe studimi të nivelit të parë (cikli I) “Bachelor”, nivelit të dytë (cikli II) “Master i Shkencave”, dhe “Master Profesional”.

Akreditimi i parë institucional i AU është bërë me Vendim Nr. 197, datë 10.04.2004. Akreditimi i fundit institucional i AU është bërë me Vendim Nr. 01, datë 24.01.2020.

Departamentet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore janë:

- Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative;
- Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes;

Universiteti Albanian University ofron programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor me qëllim kryesor të edukimit dhe formimit të edukatorëve dhe specialistëve të ardhshëm në arsimin parashkollor. Programi i studimit hartohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Universitetit Albanian University dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe educative shoqërore. Ky program studimi ofron formimin e profesionistëve - edukues. Bazuar në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, konstatojmë se aftësimi praktik dhe teorik, mundësohet i barabartë për të gjithë studentët-kandidat, pa marrë parasysh racën, gjininë, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën dhe aftësitë fizike. Programi i studimit synon të formojë dhe edukojë specialistët e rinj në fushën e mësuesisë në arsimin parashkollor.

Njësia bazë, DEA, është mbikqyrëse për cilësinë e mësimdhënies, zhvillon aktivitetin kërkimor-shkencor, kultivon dhe ruan konceptin edukativ kombëtar. Programi i studimit është në përputhje me Kodin e Cilësisë së AL (1); Manualit për Procedurat dhe Afatet për Vlerësim të Cilësisë në kuadër të akreditimit të IAL (2); Udhëzimit dhe Standardit për Sigurimin e Cilësisë dhe Hapësirës Europiane të AL.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, bazuar në procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka ndjekur trajnimin paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të vlerësimit dhe plotësimit të raportit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacionet të mledhura nga shqyrtimi i Dokumentacioneve të paraqitura në Dosjen e vlerësimit nga Universiteti Albanian University (Fakulteti i Shkencave Shoqërore) dhe vizitës së realizuar në këtë process. Vlerësimet bëhen mbi bazën standarde I deri në VI dhe kriterëve respektive. Shkalla e përmbushjes së standardit bëhet për çdo kriter, ndarë në katër nivele (standardi nuk përmbushet, pjesërisht përmbushet, kryesisht përmbushet dhe plotësisht përmbushet). Koordinimi i procesit është bërë nga ASCAL, në përputhje me afatet e caktuara.

Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga ekspertët Prof. Dr. Edi Puka dhe Dr. Shqipe Shyti, asistuar nga Msc. Anilda Beqiraj, përfaqësuese e ASCAL.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentacionin dhe informacionet e përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm. Dokumentacioni i vënë në dispozicion ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Jashtëm. Gjithashtu, informacionet e detajuara janë marrë edhe gjatë vizitës në Universitetin Albanian University, Fakultetin e Shkencave Shoqërore, zhvilluar në datat 13 dhe 14 Dhjetor 2023.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në këtë raport, është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi dhe profesionalizëm cilësinë e programit të studimit që ofrohet nga Universiteti Albanian University, Fakultetin e Shkencave Shoqërore (Njësia bazë DEA).



GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, evidenton si më poshtë vijon:

STANDARDI II - Konkluzione:

GVJ komenton: Institucioni i arsimit të lartë, Albanian University dhe Departamenti Përgjegjës për programin Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me rrjete partnere dhe në mënyrë sistematike tërheq mendimin e studentëve në lidhje me përmirësimin e programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, por përfshirja e këtyre partnerëve dhe vetë studentëve në përmirësimin e programit dhe realizimin me sukses të tij nuk është pasqyruar në asnjë dokumentacion dhe evidencë.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DEA argumenton: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka përfaqësues të studentëve në çdo komision dhe vendimmarrje. Në komisionin e përhershëm për kurrikulat dhe mësimin, ka përfaqësues nga radha e studentëve, i cili merr pjesë në mbledhjet e organizuara dhe jep sugjerime mbi ndryshimin e planeve të programeve të studimit.

Përgjigjja e GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit për të marrë masa në përfaqësimin e studentëve në organet respektive, por evidencat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dokumentuar një prezencë dhe pjesëmarrje reale të tyre.

Sa më sipër, **GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.**

STANDARDI IV.3- Konkluzione

GVJ komenton: Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka e AU ka një fond fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi specifik dedikuar kurseve me karakter pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të parë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë: rekomandohet shtimi i fondit të teksteve fizik dhe elektronik në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studentëve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm. Gjithashtu, mjedisi i bibliotekës është tërësisht i papërshtatshëm, vendosur në katin e nëndheshëm me mungesë të ndriçimit natyral. Sa më sipër, ky standard përmbushet pjesërisht.

Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DEA argumenton: Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimin e syllabuseve, bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër. Në funksion të programeve që ofron DEA, janë dhuruar shumë tituj të ndryshëm nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, si dhe nga lektorë të departamentit. Departamenti, do të marrë në konsideratë rekomandimin duke i kushtuar një rëndësi të veçantë pasurimit të bibliotekës për Vitin Akademik 2024-2025.



Përgjigja e GVJ: GVJ vlerëson përkushtimin e institucionit dhe angazhimin e tij në pasurimin e nevojshëm të literaturës përkatëse në të ardhmen për programin e studimit.
Sa më sipër, GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet pjesërisht.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 81, datë 5/10/2019 janë:

- Institucioni të rishikojë planin mësimor të këtij program studimi, me qëllim përshtatjen plotësisht të tij me "Standardet e përgjithshme të formimit të mësuesit parashkollor"(Izha 2017);
- Institucioni të rishikojë kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarive formuese, në përputhje me VKM 41, datë 24.01, 2018 " Për elementë të programeve të studimit të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë";
- Institucioni të shtojë bashkëpunimet dypalëshe me institucione ndërkombëtare, me qëllim përfshirjen më të madhe të stafit akademik dhe studentëve të këtij program studimi me projekte dhe programe mobiliteti;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për plotësimin e rekomandimit 1 dhe 2, institucioni ka bërë ndryshime në planin mësimor të programit me vendim senati Nr.13, datë 20.04.2020 dhe miratuar nga MASR me shkresë 2481/1, datë 20.05.2020, të paraqitura në evidencën R I.

Standardet për mësuesin e arsimit parashkollor janë:

Standardi 1. Zbatimi i kodit të etikës

Standardi 2. Bashkëpunimi me kolegët, familjarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit

Standardi 3. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e vet profesional

Standardi 4. Zbatimi i dokumentacionit të ri kurrikular të arsimit parashkollor

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies dhe zbatimi i teknologjisë

Standardi 6. Rritja, zhvillimi dhe mënyrat si nxënë fëmijët parashkollorë

Standardi 7. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

Standardi 8. Mbrojtja fizike dhe shëndeti

Standardi 9. Mjedisi fizik

Standardi 10. Vlerësimi në arsimin parashkollor.

- Në VKM nr.41, datë 24.01.2018 " Për elementët e studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të lartë, veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;

ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;

iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;

iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në

praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, për programin Bachelor është si më poshtë:

A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme

15% - 20% (kredite)

B- LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën shkencore

50% - 55% (kredite)

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 12% -15% (kredite)

D - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika

Profesionale 10-15% (kredite)

E DETYRIME PËRMBYLLËSE 3%-5% (kredite)

Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor”

Lënda gjuhë e huaj, anglisht, kalon nga kategoria C në kategorinë D

Është shtuar lënda Vlerësim, e kategorisë B, në vitin e dytë.

Është shtuar lënda Edukimi dhe bashëpunimi me prindërit, në vitin e tretë

Ndryshimet e tjera konsistojnë në heqje e shtim kreditesh për lëndë ekzituese. Për sa më sipër **GVJ vlerëson se rekomandimet janë përmbushur plotësisht.**

Në përgjigje të rekomandimit 3, institucioni ka siguruar bashkëpunime me Universitetin KIRCHLICHE PÄDAGOGISCHE HOCHSCHULE, në të cilin kanë zhvilluar mobilitet Erasmus, 2 pedagogë dhe 2 studentë të programit.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimeve	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

Rekomandimi i parë: Rishikimi i planit mësimor.				X
Rekomandimi i dytë: Rishikimi i kategorizimit të lëndëve				X
Rekomandimi i tretë: Bashkëpunimet dypalëshe e ndërkombëtare.				X



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mësuesi për Arsim Parashkollor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua që: Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin parashkollor”, është një program që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe i përgjigjet kërkesave të kohës dhe perspektives së zhvillimit të vendit duke synuar ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky program është i organizuar dhe funksionon sipas Planit Strategjik të Universitetit, në të cilin pika III.e dhe III.f, shprehin sa më sipër.</p> <p>Evidenca 1.2.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022.pdf</p> <p>Evidenca 1.2.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028.pdf</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se programi është konceptuar dhe hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë, por edhe me nevojat kombëtare e lokale, duke synuar që të mbajë gjallë traditën dhe të sigurojë vazhdimësinë e AU-së si një qendër për përgatitjen e mësuesve të Arsimit parashkollor. Kjo është e shprehur dhe në rregulloren e programit.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e Programit Bsc. Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf.</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është hartuar në përputhje me Planin Strategjik të institucionit, në përputhje me Rregulloren e institucionit dhe me fushat e drejtimet akademike te tij. Si pjesë e Fakultetit të të Shkencave Sociale, dhe Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, programi “Mësuesi për Arsimin parashkollor” është në harmoni me të gjithë aktet rregulluese të Universitetit, Fakultetit, si dhe të Departamentit, që e ofron.</p>

	<p>Evidenca 1.2.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022.pdf</p> <p>Evidenca 1.2.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028.pdf</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e Programit Bsc. Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf.</p> <p>Evidenca I.4 Plani Strategjik i Departamentit.pdf.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi studimit “Mësuesi për arsim parashkollor ” ka një staf të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë, por <i>rekomandohet që t’i kushtohet më shumë vëmendje formimit të pedagogjik të pedagogëve dhe sidomos atyre me formim përkatës pedagogjik e profesional për arsimin parashkollor. Në këtë program edukimi, numri i pedagogëve me formim pedagogjik është i ulët në krahasim me numrin e stafit që kanë formim të fushave shkencore.</i></p> <p>Infrastuktura e ofruar në shërbim të programit, e paraqitur dhe në tabelën 16 plotëson kushtet (7m² per student) e duhura për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Tabela Aneks RVB Mësues për Arsimin parashkollor. Tabela 16</p> <p>Evidenca: Evidenca shitesë: http://ams.ascal.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeline.php?id=20272</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit te studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, DEA.</p> <p>Institucioni ka kryer procedurat për kodifikim e programit (MAF-A) duke u mbështetur në Udhëzimin e MAS, Nr. 31, datë 15,10.2022, nenin 86 të Ligjit për IAL 80/2015, dhe është në proces për aprovimin e tyre nga MAS.</p> <p>Evidenca I.6 Shkresa për kodifikimin e programeve të studimit.pdf.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës 2 ditore u konstatua që Institucioni i arsimit të lartë, Albanian University, ofron programin e studimit, Bsc në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, në përputhje me misionin dhe qëllimin</i></p>

	<i>e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Plani strategjik i Institucionit, Departamentit dhe rregulloret e Institucionit dhe programit tregojnë që ky program funksionon sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Institucioni AU, në kuadër të aftësimit profesional dhe kërkimit shkencor ka ngritur struktura brenda tij që bashkëpunojnë me njëra tjetrën, si: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e karrierës dhe alumni, Zyra e mbështetjes për studentët.</p> <p>Departamenti bën analizë të përvitshme të punës ku pasqyrojnë dhe këtë bashkëpunim, si dhe ndarjen e detyrave mes personelit të njësisë bazë. Raporti vjetor i Departamentit, i realizuar nga grupet e punës për secilin program, e pasqyrojnë këtë marrëdhënie bashkëpunimi.</p> <p>Bashkëpunimi midis departamenteve të Fakultetit në funksion të realizimit të programit është i dukshëm në stafin e angazhuar për realimin e programit, sidomos me stafin e Departamentit të Psikologjisë.</p> <p>Evidenca I.12 Raporti vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes v.a 2021-2022</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe	Institucioni AU, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit ka marrëveshje me 13 institucione të Arsimit të lartë në vend, Zyrat arsimore dhe Drejtoritë arsimore si dhe me 23 institucione të arsimit të lartë në Europë e një në Kinë. Një student ka kryer studimet në kuadër të mobilitetit në vitin akademik 2021-2022 dhe një në vitin akademik 2022-2023. Gjithashtu 2 pedagogë kanë zhvilluar

<p>brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>mësimdhënie në kuadër të Erasmus + project në Universitetin e Kirchliche Pädagogische Hochschule Edith Stein.</p> <p>Evidenca R.I Mobiliteti i studenteve 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca R.II Mobiliteti i stafit akademik 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca R.IV Mobiliteti i studenteve 2022-2023.pdf</p> <p>Evidenca R.V Mobiliteti i stafit akademik 2022-2023.pdf</p> <p>Evidenca R.VI Konferenca shkencore.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni ka një marrëveshje me ZVA, me numër protokollit 1885, datë 29/10 /2019 për realizimin e praktikave profesionale në shkollat 9-vjeçare të Qarkut të Tiranës, në të cilën theksohet lejimi i studentëve të për zhvillimin e praktikës. Nga takimet me stafin u evidentua se pedagogu përgjegjës për praktikat kishte listat e studentëve me shkollat e kopshtet ku kishin kryer praktikat dhe dosjet e praktikës për secilin student.</p> <p>Evidenca:I.8 Marreveshje me ZVA.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti kryen analizë semestrale dhe vjetore për punën e tij. Në këtë analizë mungojnë raportet analitike për marrëveshjet me ZVA, por është pasqyruar vetëm analiza për mobilitetin e studentëve në kuadër të Erasmus + project.</p> <p><i>Rekomandohet që në analizat e tij semestrale dhe vjetore departamenti të analizojë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit: Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor.</i></p> <p>Evidenca III.13 Raport semestral departamenti v.a. 2022-2023</p> <p>Evidenca I.12 Raporti vjetor I Departamentit te Edukimit dhe Anglishtes v.a 2021-2022.pdf.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i Arsimi të lartë, Albanian University dhe njësia përgjegjëse për programin Bsc. Mësuesi për arsimin parashkollor, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të fushës brenda dhe jashtë vendit, si me zyrat arsimore vendore për realizimin e praktikave mësimore, ashtu dhe me institucione arsimore qe arsimi të lartë që ofrojnë programe të njëjta studimi, duke realizuar dhe mobilitete të stafit dhe studentëve.</i></p>

	<i>Rekomandohet që në analizat e tij semestrale dhe vjetore departamenti të analizojë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit: Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit bachelor “Mësuesi në Arsim parashkollor” shtrihet në 3 vite akademike. Për secilin vit akademik janë të përcaktuara qartë lëndët dhe modulet si dhe kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS), 60 kredite në një vit akademik dhe 180 kredite për të gjithë ciklin. Evidenca II.1 Kurrikula Bsc ne Mesues per Arsimin Parashkollor.pdf.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose	Programi i studimit Bachelor “Mësuesi në Arsim Parashkollor” është i hartuar duke u mbështetur në lëndë bazë, lëndë plotësuese dhe ndërdisiplinore, me qëllim përgatitjen e tyre për profesionin e mësuesit të arsimit parashkollor dhe vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve master në profilin e mësuesisë dhe edukimit. Në programin mësimor konstatohet që lëndëve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëmb site: e e .ascal.al

<p>punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>formimit pedagogjik nuk i janë dhënë hapësirat e duhura. Në kurrikul evidentohet që:</p> <p>Lëndët: Teoritë e të nxëniet dhe Etika janë lëndë me zgjedhje;</p> <p>Lënda: Media – tregimi përralla - është në kategorinë A, ndërkohë që lënda: Letërsia për fëmijët e moshës parashkollore e kategorisë B.</p> <p><u>Mungojnë</u> lëndë të cilat do të aftësonin studentin në profesionin e tij për zhvillimin e kurrikulës në kopsht, qasjet metodologjike bashkëkohore në kopsht, si dhe lëndë të përgjithshme të formimit pedagogjik, si: pedagogjia, shkenca edukimi, metodologji mësimdhënie,</p> <p><i>Rekomandohet rishikimi i kurrikulës duke synuar formimin pedagogjik të studentëve e pajisjen e tyre me njohuri të përditësuara për zbatimin e kurrikulave të kopshtit dhe duke u mbështetur në qëllimet e kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor dhe nevojave të mësuesve të Arsimit parashkollor.</i></p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula BSc ne Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf</p> <p>https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2018/03/Korniza-Kurrikulare-e-arsimit-parashkollorit-IZHA-Dhjetor-2016.pdf</p> <p>https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/01/Arsimi-Parashkollor-5-6-vjec.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në planin mësimor të paraqitur nga Institucioni për programin “Mësuesi për Arsimin parashkollor” janë të përcaktuara veprimtaritë formuese dhe lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, duke plotësuar kriteret e vendosura për peshën e tyre në kurrikul, por ndarja e tyre në kategori duhet riparë.</p> <p><i>Rekomandohet të rishihen e kategorizohen lëndë të tilla si: Teoritë e të nxëniet dhe Etika e profesionit, Edukim mjedisor dhe Edukimi shëndetësor, Njohuri për shkencat e natyrës, të cilat janë planifikuar si lëndë ndërdisiplinore në kategorinë C. Po kështu dhe lënda: Njohuri për historinë e Shqipërisë që është planifikuar si lëndë me zgjedhje.</i></p> <p>Lënda: Media (tregimi, përralla) në trajtimin e saj është didaktikë e letërsisë, dhe duhet të emërtohet si e tillë.</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula e BSc ne Mesuesi per Arsim Parashkollor. Pdf</p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p>

	<p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në program janë të përcaktuara praktikat profesionale (lëndë e kategorisë D 10-15 % e krediteve), si më poshtë:</p> <p>viti II dytë, semestri 1+2, 9 (4+5) kredite;</p> <p>Viti III, semestri 1+2, 12 kredite. në total 21 kredite ose 11 % e krediteve,.</p> <p>Konstatohet që Programi i studimit Bsc.në Mësues për Arsimin parashkollor i ka të mirëpërcaktuara si ngarkesën në kredite ashtu dhe detyrimet përmbyllëse të studentit.</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula e BSc ne Mesuesi per Arsim Parashkollor. Pdf</p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>AU nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi Bachelor “Mësuesi në arsimin parashkollor” është program që ofrohet nga ky institucion dhe si programe të ngjajshme mund të futen programe në Bachelor në Mësuesi për arsimin fillor, me të cilin ka përmbajtje të ngjajshme deri në 70%.</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula e BSc ne Mesuesi per Arsim Parashkollor. Pdf</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra</p>	<p>Kodifikimi i programit është kryer nga institucioni dhe është në proces aprovimi nga MAS.</p> <p>EvidencaI.6 Shkresa per kodifikimin e programeve.pdf</p>

publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.									
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vënda apo të huaj.								
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit bsc. Mësuesi për Arsimin parashkollor është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Në këtë program janë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, si dhe ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</i></p> <p><i>Rekomandohet futja e lëndëve të karakterit pedagogjik dhe rishikimi i kategorizimit të lëndëve, duke u respektuar standardet mësuesit të Arsimit parashkollor dhe Kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor.</i></p> <p>https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2018/03/STANDARDET-E-MESUESIT-TE-ARSIMIT-PARASHKOLLOR-draft.pdf</p> <p>https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2018/03/Korniza-Kurrikulare-e-arsimit-parashkollorit-IZHA-Dhjetor-2016.pdf</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Departamentet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore janë:




përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

- Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative;
- Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes;

Ky departament ka realizuar organizimin dhe strukturën akademike, stafin akademik dhe akreditimin sipas dispozitave në fuqi. Programi Bachelor "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është program që e ofron Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Stafi i departamentit për tre vitet akademike është si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	2	1	1	1	1
Prof. Asoc.	2	1	2	2	2	5
Dr./PhD.	6	14	6	15	6	12
Msc.	-	3	-	4	-	4
Totali	9	20	9	22	9	22

Programi funksionon sipas rregullores së institucionit, dhe duke u mbështetur në Ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, neni 25 të ligjit 80/2015 në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike.

Ky program funksionon sipas rregullores së Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Programi është i akredituar për herë të parë me VBA Nr. 35, datë 19.05.2017 dhe VBA Nr. 81, datë 05.10.2019, për akreditimin periodik.

Evidenca:

<http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivave.php?id=12297>

<http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivave.php?id=28399>

Evidenca II.3 Rregullore Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.pdf

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e

Në evidencat e paraqitura nuk ka tregues për angazhimin e personelit ndihmës akademik/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, praktikat mësimore zhvillohet vetëm nga një pedagog me kohë të plotë, siç paraqitet dhe në

<p>përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>syllabysset e praktikës dhe evidencat tabelat aneks të RVB. Departamenti ka 9 lektorë efektivë që mbulojnë këtë program dhe plotësojnë 70% të ngarkesës së programit dhe 22 lektorë të jashtëm.</p> <p>Evidenca: http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeline.php?id=20268</p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p> <p>Tabela 14. Tabelat aneks RVB Bsc Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf</p> <p>Tabela 2. Tabelat aneks RVB Bsc Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se Dr. E.S është përcaktuar si koordinatore të programit të studimit, me shkresën me numër protokollit 916, datë 29.09 2021 e FShSh, DEA. Gjatë vizitës dy ditore Koordinatorja e programit tregon që njeh detyrat e saj dhe merret me ecurinë e programit, problematikat e studentëve, përmbajtjen e syllabuseve, orientimin e studentëve për provimin përfundimtar, rekomandimet e Vlerësimit të jashtëm dhe raporton në mënyrë të rregullt në departament.</p> <p>Evidenca II.5 Koordinatori I programit.pdf.</p> <p>Evidenca: http://ams.asc.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeline.php?id=20268#collapse-21380</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, që është dhe Departamenti që ofron programin Bsc Mësuesi për Arsimin Parashkollor, përmbush kryesisht kërkesat ligjore duke zbatuar rregulloren e departamentit në lidhje me organizimin, stafin akademik e vlerësimin.</i></p> <p><i>Caktimi i personelit ndihmës për zhvillimin e praktikave, hartimi i rregullores për praktikën profesionale si dhe dokumentimi i raportimeve të koordinatorit të programit jepen si rekomandime për përmirësimin e këtij kriteri.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë për këtë program është Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Gjatë vizitës dyditore u konstatua që njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit.</p> <p>http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/proceduraviee.php?id=163466</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në planin mësimor të paraqitur nga Institucioni, në evidencën II.1 janë të paraqitura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndarja në semestra e lëndëve; 2. Ngarkesa mësimore e lëndëve / Moduleve; 3. Orët në auditor dhe jashtë auditorit; <p>Gjithashtu në syllabyse paraqiten në mënyrë të detajuar, orët në auditor dhe jashtë auditorit, ngarkesa mësimore e lëndëve dhe numri i krediteve për secilën lëndë.</p> <p>Viti i parë: 1500 ore mesimore, nga të cilat 631 ne auditor dhe 869 jashtë auditorit.</p> <p>Viti i dytë: 1500 orë në total, nga të cilat 689 ne auditor dhe 811 jashtë auditorit,</p> <p>Viti i tretë: 1500 orë në total, nga të cilat 710 ne auditor dhe 790 jashtë auditorit.</p> <p>Lëndët bazë 32 kredite gjithsej ose 17.8% e krediteve në total. Lëndët karakterizuese 95 kredite, 52.8 % e krediteve në total. Lëndët ndërdisiplinore 22 kredite, 12.2 % e krediteve në total. Lëndët plotësuese 25 kredite, 13.9% dhe Detyrimet përmbyllëse 6 kredite, 3.3 % e krediteve në total</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula Bsc Mesuesi per Arsimin Parashkollor.pdf.</p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p>

	<p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, janë të paraqitura në Rregulloren e “Regjistrimeve dhe Transferimeve “, në të cilën jepen me hollësi të gjitha kriteret, dhe si funksionon Zyra e transferimeve dhe ekuivalenteve, që ka në përgjesinë e saj, sipas nenit 3 të rregullores së sipërpërmendur realizimin e pranimeve, regjistrimeve, transferimeve dhe ekuivalenteve.</p> <p>Evidenca II.7 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve VS 25-dt 25.06.2020.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në syllabuset e paraqitura në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni janë të përshkruara për secilën lëndë, të gjitha komponentet formues të programit në përputhje me formatet: Titulli i lëndës, lektori, ngarkesa, koha e realizimit, tipologjia e lëndës, miratimi nga titullari dhe përgjegjësi i departamentit, rezultatet e synuara, përmbajtja, literatura, metodologjia e mësimdhënies dhe mënyra e vlerësimit.</p> <p><i>Rekomandohet që hartimi i rezultateve mësimore të te paraqitet me terminologjinë e duhur, sepse herë janë paraqitur si objektiva mësimore, herë në formë narrative, si pjesë e përmbledhjes së lëndës, dhe më së shumti janë të nivelit njohës, duke kufizuar formimin e kompetencave të lëndës të studentit.</i></p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur jepet një dokument, <i>Evidenca II.8</i>, në të cilën kërkohet që për rishikimin e syllabuseve të ndiqen procedurat e dhëna të kalojnë nëpërmjet zyrës së kurrikulës, por nuk janë të pasqyruara syllabuset e ndryshuara dhe ku konsiston ky ndryshim. Rishikimi i planeve mësimore është bërë si kërkesë e plotësimit të kërkesave të bordit të akreditimit.</p> <p>Evidenca R.I.Ndryshimet ne Planet Mësimore.pdf</p> <p>Evidenca II.8 Procedure rishikimi syllabusi.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>U konstatua se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, si njësi përgjegjëse për programin ka informacionin e duhur në lidhje me programin e studimit Bsc. Mësuesi për Arsimin</i></p>

	<p><i>Parashkollor. Programi i studimit Bsc Mësuesi për Arsimin parashkollor përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, të cilat janë të dhëna në rregulloret e rregjistrimeve dhe transferimeve.</i></p> <p><i>Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin parashkollor përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit sipas udhëzimit 41 të MAS.</i></p> <p><i><u>Rekomandohet</u> rishikimi i syllabyseve përsa i përket përcaktimit të rezultateve mësimore sipas niveleve të njohjes e kompetencave të lëndës në mënyrë të qartë e të saktë.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi Bachelor “Mësues për Arsimin Parashkollor” përmban veprimtari që sigurojnë njohuritë bazë shkencore e praktike për punësimin e tyre si mësues të arsimit parashkollor</p> <p><i>Rekomandohet përfshirja e lëndëve të tilla, si pedagogji, shkencë edukimi, pra lëndëve me karakter pedagogjik të përgjithshëm do ishte më ndihmuese për studentët, për të marrë bazat e profesionit, për të njohur qasjet metodologjike në moshën parashkollore e mënyrat e vlerësimit në arsimin parashkollor.</i></p> <p>Evidenca II.1Kurrikula Bsc Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet që hartimi i planit mësimor, duke filluar që nga shpërndarja në vite e semestra, kreditet për secilën lëndë, bëjnë të mundur arritjen e objektivave formuese të programit dhe arritjen e rezultateve të</p>

<p>kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit.</p>	<p>synuara të të nxënit, duke i dhënë mundësi studentit të marrë baza teorike e praktike të punës së mësuesisë dhe t'i thellojë këto më tej në studimet master.</p> <p>Evidenca II.1Kurrikula Bsc Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Mënyra e strukturimit të programit, orët e leksioneve, seminareve, praktikave janë në përputhje me profilin e programit Bsc Mësuesi për Arsimin parashkollor. Raporti teori praktikë është i përafërt me programe të ngjashme të cilat përgatitin mësues të arsimit fillor.</p> <p>2030 orë mësimi në auditor për tre vite akademike, nga të cilat Praktika 653 orë mësimore.</p> <p>Evidenca II.1Kurrikula Bsc Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e veprimtarive formuese, dhe raporti teori praktikë mundëson arritjen e objektivave formues në profilin Mësues për arsimin parashkollor, si dhe transferim të studimeve, ose mobilitet. Në dokumentacionin e paraqitur, paqyrohen dhe dy raste mobiliteti të studentëve të Arsimit Parashkollor.</p> <p>Evidenca: R.II Mobiliteti i studenteve 2021-2022.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në syllabuset e programit janë të paraqitura në mënyrë të detajuar tekstet që janë përdorur si literaturë e detyruar apo e rekomanduar. Konstatohet që tekstet e literaturës së detyruar ka raste që janë të një niveli më shkencor seç e kërkon profili dhe emërtimi i lëndës, pasi emërtimet e lëndëve janë të tilla, që e kufizojnë marrjen e njohurive të thella në matematikë, letërsi, shkenca etj.</p> <p>Ka lëndë që kanë si literaturë të detyruar 12 tekste, dhe si literaturë të rekomanduar 2 tekste. Literatura e përdorur në lëndën praktikë shkollore e Vlerësim janë shumë të përgjithshme dhe nuk fokusohen në veçantitë e arsimit parashkollor.</p> <p><i>Rekomandohet të rishihet literatura e përdorur në syllabusët e praktikës mësimore duke mundësuar njohjen e studentëve si me kurrikulat të cilat punohen në kopsht, ashtu dhe me metodologjitë që përdoren për arritjen e qëllimeve të kurrikulës, të shprehura në Kornizën kurrikulare të arsimit</i></p>



	<p><i>parauniversitar. Gjithashtu, rekomandohet të rishihet literatura e detyruar, jo vetëm në numër, por dhe në specifikime.</i></p> <p>Evidenca II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me rezultatet e synuara nga Institucioni, por jo në aftësi e kompetenca për aftësimin për tregun e punës. Kjo pasi syllabuset në tërësinë e tyre konsistojnë në anën teorike dhe jo në anën praktike, pra sesa dhe si këto njohuri do të shërbejnë studentëve për t'i aplikuar në profesionin e tyre, si dhe në mënyrën sesi këto njohuri të mësuara mund të jenë të vlefshme për zhvillimin e mësimin në arsimin parashkollor.</p> <p>Mungesa e lëndëve të tilla si: pedagogji, shkenca edukimi, pra lëndëve me karakter pedagogjik të përgjithshëm, si dhe atre më specifike, si p.sh qasjet metodologjike në grup moshat 3-6 vjeç është evidente në kurrikulën e programit Bachelor “Mësuesi për Arsimin fillor”. Gjithashtu vihet re që literatura e përdorur në syllabuse nuk është e përditësuar me zhvillimet e reja në fushën e pedagogjisë dhe arsimit parashkollor.</p> <p><i>Rekomandohet përditësimi i planit mësimor dhe syllabuseve. Përfshirja e lëndëve me karakter pedagogjik, si dhe përditësimi i literaturës në syllabuset mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit në tërësinë e tij mundëson futjen në tregun e punës si mësues i arsimit parashkollor.</p> <p><i>Rekomandohet rishikimi e përditësimi i planeve mësimore dhe syllabuseve duke u azhornuar me zhvillimet e reja, si në kurrikulat e arsimit parauniversitar.</i></p> <p>Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programet të studimit Bsc. Në mësuesi për Arsimin Parashkollor është kryesisht në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. U konstatua se përmbajtja e këtij programi duhet të jetë më afër profesionit dhe tregut të punës, me qëllim arritjen e kompetencave të</i></p>

	<p><i>mësuesit të arsimit parashkollor, duke synuar më formimin e kompetencave të vlefshme për kohën.</i></p> <p>Rekomandohet përfshirja e lëndëve të tilla, si pedagogji, shkenca edukimi, pra lëndëve me karakter pedagogjik të përgjithshëm do ishtë më ndihmuese për studentët, për të marrë bazat e profesionit, për të njohur qasjet metodologjike në moshën parashkollore e mënyrat e vlerësimit në arsimin parashkollor. Gjithashtu, rekomandohet rishikimi i literaturës dhe rishikimi i planeve mësimore me qëllim që të jenë më afër zhvillimeve të reja në fushën e pedagogjisë dhe arsimit parashkollor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit, njësitë përgjegjëse për këtë program, DEA, ka ndryshuar planin mësimor sipas sygjërimeve të Bordit të Akreditimit.</p> <p>Në analizën e tregut që paraqitet si evidencë për këtë kriter është pasqyruar nevoja për mësues të arsimit parashkollor, por nuk janë të pasqyruar nevojat e mësuesve në sistem, si dhe një analizë e dokumenteve kurrikulare (korniza kurrikulare, programe të Arsimit parashkollor) që mund të kërkojnë ndryshimin dhe të përmbajtjes së planeve mësimore. Gjithashtu Njësitë përgjegjëse për programin, DEA, zhvillon çdo vit akademik pyetësorë me studentët e programit për tërheqjen e mendimeve të tyre mbi përmirësimin e këtij programi.</p> <p>Evidenca R.I Ndryshimet ne planet mesimore.pdf.</p> <p>Evidenca II.9 Analiza e tregut te punes.pdf</p> <p>Evidenca II.9.a Pyetesori i studenteve per mesimin online v.a. 2019-2020.pdf</p> <p>Evidenca II.9.b Pyetesori i studenteve per mesimin online v.a. 2020-2021.pdf</p>



	<p>Evidenca II.9.c Pyetesori i studenteve per v.a. 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca II.9.d Pyetesori i studenteve per v.a. 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>DEA, zhvillon çdo vit akademik pyetësorë më studentët e programit për tërheqjen e mendimeve të tyre mbi përmirësimin e këtij programi, por nuk pasqyrohen në dokumentacion takime me studentë alumni, me qëllim tërheqjen e mendimeve për përmirësimin e programit të studimit Bsc. Mësues për Arsimin parashkollor.</p> <p>Evidenca II.9.a Pyetesori i studenteve per mesimin online v.a. 2019-2020.pdf</p> <p>Evidenca II.9.b Pyetesori i studenteve per mesimin online v.a. 2020-2021.pdf</p> <p>Evidenca II.9.c Pyetesori i studenteve per v.a. 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca II.9.d Pyetesori i studenteve per v.a. 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në dokumentacionin e shqyrtuar konstatohet se Institucioni, Albanian University dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera që operojnë në këtë fushë. Të dhënat nga dokumentacionet nuk tregojnë se si institucioni bashkëpunon me rrjete profesionistësh, apo shoqata e institucione publike dhe cilat janë propozimet që këto kanë dhënë për këtë program, dhe si janë pasqyruar në kurrikulën e programit për përmirësimin e tij.</p> <p><i>Rekomandohet që bashkëpunimet e marrëveshjet e institucionit për këtë program të jenë më të lidhura me profilin e programit e të pasyrohen në dokumentacione, sesi këto marrëveshje merren në konsideratë për përmirësimin e tij.</i></p> <p>Evidence I.7 Marreveshje te bashkepunimit.pdf.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë, Albanian University dhe Departamenti Përgjegjës për programin Bsc Mësues për Arsimin parashkollor, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me rrjete partnered he në mënyrë sistematike tërheq mendimin e studentëve në lidhje me përmirësimin e programit të studimit Bsc Mësuesi për arsimin parashkollor, por përfshirja e këtyre partnerëve dhe vetë studentëve në përmirësimin e programit dhe realimin me sukses të tij nuk është pasqyruar në asnjë dokumentacion dhe evidencë.</i></p>

	<i>Institucioni duhet të përfshijë partner (biznese, organizima, rrjete, dhe student alumni) në takime reflektuese ku mendimi i tyre të merret në konsideratë e të dokumentohet e pasqyrohet në ndryshimet në plane e veprimtari mësimore në funksion të përmirësimit dhe arritjes së objektivave të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në syllabysët e paraqitura nga institucioni, format e mësimdhënies janë: Leksion. Seminar, punë laboratorike, praktika profesionale. Krahas këtyre veprimtarive, DEA realizon dhe konferenca studentore, orë të hapura e ëorkshop-e, të gjitha këto forma të miratuara nga institucioni. Evidenca: II.6.a Syllabuse viti I.pdf Evidenca II.6.b Syllabuse Viti II.pdf Evidenca II.6.c Syllabuse viti III.pdf Evidenca III.1 Lista e aktiviteteve shkencore 2019-2023.pdf.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të	Konstatohet se në dokumentacionin e paraqitur nuk ka evidence për forma e mënyra mësimdhënie në përshtatje me nevojat e studentëve. Leksioni, seminari, dhe diskutimi e bashkëbisedimi janë mënyrat e vetme të paraqitura.

<p>mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës dy ditore, në takime me studentët e stafin, u evidentua, që gjatë mësimdhënies përoren dhe puna me projekte, puna me grupe, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit, institucioni ndërmer një sërë veprimtarish, si: mbështetje financiare për botime e konferenca, trajnime për stafin, të paraqitura këto në evidencat e paraqitura. Gjithashtu stafi akademik ka zhvilluar mobilitete akademike që kanë ndihmuar në shkëmbimin e përvojës, literaturës dhe futjen e elementëve bashkëkohorë në procesin mësimor dhe rritjen e aftësive mësimdhënese. Konferencat studentore, trajnimet e bëra nfa institucioni tregon qarte se institucioni bën përpjekje për zhvillimin profesional e akademik të anëtarëve të stafit. Kjo pasyrohet dhe në CV-të e stafit akademik.</p> <p>Evidenca I.9.a Konferenca studentore 1.pdf</p> <p>Evidenca I.9.b Konferenca studentore 2.pdf</p> <p>Evidenca III.2 Shkresat për mbështetje financiare.pdf</p> <p>Evidenca III.3 Procedura e mbështetjes financiare Dr. Albana Tahiri.pdf</p> <p>Evidenca III.4.a Axhenda e trajnimeve stafi akademik v.a. 2019-2020.pdf</p> <p>Evidenca III.4.b Axhenda e trajnimeve stafi akademik v.a. 2020-2021.pdf</p> <p>Evidenca III.4.c Axhenda e trajnimeve stafi akademik v.a. 2021-2022.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin Bsc. Mësuesi për arsimin parashkollor, është një staf i kualifikuar me grada e tituj shkencorë. Gjatë vizitës dy ditore në takimet me studentët u konstatua që stafi akademik është kompetent dhe i angazhuar në procesin mësimor, duke nxitur te studentët mendimin kritik e krijues, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë e sipërmarrjes.</p> <p>Anëtarët e stafit akademik gëzojnë respekt te studentët, pasi kanë krijuar me ta marrëdhënie bashkëpunimi korrekte e profesionale.</p>




dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	<p>Institucioni, në funksion të përmirësimit të programit dhe mësimdhënies, realizon pyetesorë me studentë, vlerëson në mënyrë vjetore stafin, nëpërmjet vetëvlerësimit, vlerësimit të përgjegjës të departamentit dhe studentëve. Vlerësimi i përgjegjës nuk jep informacion të hollësishëm për performacën dhe problematikat që ka pedagogu.</p> <p>Evidenca III.7 Formulari i vlerësimit të drejtuesit të departamentit.pdf</p> <p>Evidenca III.11 Raport vetëvlerësimi stafi akademik.pdf</p>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.	<p>Në nivel institucional janë organizuar struktura të tilla si: Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyra e zhvillimit të kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat e Mësimin. Zhvillimi i pyetesorëve me studentët nga NJSBC jep mundësi për reflektim në lidhje me problematikat e programit.</p> <p>Vlerësimi programeve të studimit zhvillohet nga Departamenti dhe në të është i pasqyruar plani i veprimit në lidhje me në lidhje me trajnimin e stafit për përmirësimin e cilësisë, si dhe analiza e pyetesorëve me studentë dhe focus grupe që ndihmojnë për përmirësim e aftësive metodologjike.</p> <p>Evidenca II.9.a Pyetesori i studenteve për mesimin online v.a. 2019-2020.pdf</p> <p>Evidenca II.9.b Pyetesori i studenteve për mesimin online v.a. 2020-2021.pdf</p> <p>Evidenca II.9.c Pyetesori i studenteve për v.a. 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca II.9.d Pyetesori i studenteve për v.a. 2022-2023.pdf</p> <p>Evidenca III.6 Formulari i vetëvlerësimit të programit të studimit.pdf</p>
Konkluzione	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë Albanian University dhe Departamenti përgjegjës për programin Bsc Mësuesi në Arsimin parashkollor, zhvillon procesin mësimor nëpërmjet formave, metodave të suksesshme të mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces, parë kjo si nga</i></p>

	<i>dokumentacioni i paraqitur ashtu dhe nga takimet gjatë vizitës dyditore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në rregulloren e Institucionit dhe në rregulloren e Programit të studimit janë të pasqyruara kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive.</p> <p>20% pjesëmarrja dhe angazhimi;</p> <p>20% provimi i ndërmjetëm;</p> <p>60 % provimi përfundimtar;</p> <p>Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen në sezone të përcaktuara nga Departamenti.</p> <p>Evidenca I.5 Rregullore e FSHSH.pdf</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi per arsimin parashkollor.pdf</p> <p>Evidenca II.3 Rregullore departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.pdf</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Gjatë takimeve të zhvilluara me studentët, në vizitën dy ditore në institucion rezulton se studentët informohen me metodologjitë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, që në fillim të semestrit, për secilën lëndë nga pedagogu përkatës.</p> <p>Evidenca: Shënime gjatë vizitës dy ditore ne institucion.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet nëpërmjet detyrave të kursit, testimit të ndërmjetëm e përfundimtar, zhvillohet duke</p>

<p>mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>u mbështetur në nenin 4 të rregullores së programit, dhe është e pasqyruar në syllabuse.</p> <p>Provimi i ndërmjetëm 20%;</p> <p>Ndjekja e lëndës dhe detyra kursi 20% (10 + 10);</p> <p>Provimi përfundimtar 60%;</p> <p>Vlerësim maksimal është me 100 pikë;</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për Programin Bsc. Mësuesi në arsimin parashkollor he stafi i angazhuar në realizimin e programit, gjatë javës orientuese zhvillojnë takime me studentët, që shërbejnë ndër të tjera dhe për njohjen e tyre me mënyrat e vlerësimit, si dhe realizojnë pyetësorë me studentë gjatë vitit për ecurinë e programit, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre.</p> <p><i>Rekomandohet që në pyetësorët që zhvillohen me studentët të ketë dhe pyetje për mënyrën e vlerësimit.</i></p> <p>Evidenca III.2 Axhenda e javës orientuese.pdf.</p> <p>Evidenca III.9.6 Pyetësori i studenteve v.a, 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës dy ditore në institucion u konstatua që stafi akademik i përfshirë në këtë program, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme në përputhje me rezultate e të nxënit, duke i dhënë studentëve mbështetje dhe duke ndërtuar me ta marrëdhënie respekti të ndërsjellë.</p> <p>Një mundësi që institucioni ka krijuar është dhe përdorimi i paketës Office 365, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies si dhe një mënyrë më efektive për dhënien e këshillave të udhëzimeve.</p> <p>Evidenca: Vizita dy ditore në institucion. Shënime.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglistes, si njësi përgjegjëse për programin Bsc. Mësuesi për Arsimin parashkollor në rregulloren e programit ka pasqyruar procedurat e testimit e</i></p>




	<p><i>vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre duke iu përmbajtur rregullores së programit. Studentëve iu bëhen të njohura procedurat që në fillim të semestrit dhe tërhiqet mendimi i tyre përgjatë vitit akademik. Testimet dhe vlerësimi i dijeve zhvillohet në përputhje me rregulloren dhe studentit i krijohen hapësirat dhe kushtet e nevojshme për një vlerësimin transparent.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Vlerësimi i studentëve relizohet nëpërmjet vlerësimeve të vazhdueshme të angazhimit në seminare, provimit të ndërmjetëm, provimit final. Të gjitha këto në %, 20 +20 +60, bëjnë të mundur vlerësimin final me 100 pikë. Ky vlerësim është i pasqyruar në çdo syllabys.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6,b Syllabyse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.C Syllabyse Viti III.pdf</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimi, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>U konstatua se procedura e hartimit, dorëzimit të tezës së provimit dhe sekretimit të saj bëjnë të mundur shmangien e formave të abuzimit. Në institucion nuk zhvillohen teste në formë elektronike nëpërmjet ndonjë platforme të ideuar për këtë (si, p.sh: clean score). Testet përfundimtare ose të ndërmjetme hartohen nga pedagogu i lëndës, miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe kodohen para provimit. Dekodifikimi i tyre bëhet pas vënies së pikëve përfundimtare duke shmangur forma abuzimi dhe duke rritur transparencën, duke respektuar Nenin 20, 21, 22, 23, të rregullores së programit.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi per Arsim parashkollor. Pdf</p>

<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Testimi përfundimtar ka një peshe specifike 60% të pikëve në total, dhe për vlerësimin përfundimtar ngrihet një komision.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi per Arsim parashkollor. Pdf</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas të dhënave të shkruara në RVB, pas çdo provimi realizohet një takim, në të cilin diskutohen zgjidhjet që do çojnë në përmirësim. Në takimet me stafin rezulton se këto takime planifikohen në orare të përcaktuara nga Departamenti. Në këto takime jepen sugjerime për përmirësimin e performancës së studentit.</p> <p>Evidenca: RVB Bsc Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Pedagogu i lëndës është përgjegjës për përdorimin e materialeve gjatë provimit. Gjithashtu temat e diplomës shihen për plagjiature dhe ndiqen hap pas hapi. Neni 29, Kreu V i Rregullores së programit të studimit Bsc Mësuesi për Arsimin parashkollor për temat e diplomës, ka të përcaktuara qartë kërkesat e diplomimit.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Pikëzimi i testimit dhe paanshmëria në vlerësim, sigurohet nga pedagogu përgjegjës për lëndën.</p> <p>Nenet 18, 19, 20 i rregullores së programit përcaktojnë mënyrën e organizmit, kohën dhe afatet, si dhe rregullat që zbatohen gjatë provimit. Studentët, gjatë takimeve dyditore konfirmuan zbatimin e rregullores.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Neni 23, pika 3 i Rregullores së programit Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor garanton të drejtën e studentit për t'u njohur me vlerësimin dhe rishikimin e tij</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p> <p>Po në këtë Nen të rregullores së programit të studimit, pika 4, përcaktohet ngritja e komisionit <i>Ad hoc</i> për ankimin e studentit.</p>




<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga takimet me studentët gjatë vizitës 2 ditore u konstatua që nuk ka pasur raste ankimi.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, si njësi apërgjegjëse për programin e studimit Bsc. Mësuesi për Arsimin parashkollor siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, të përcaktuara këto në rregulloren e programit. Nenet 18-23 përcaktojnë qartë procedurat e vlerësimit, rregullat që duhet të ndiqen, të drejtën për ankimin, dhe transparencën në vlerësim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi studimit “Mësuesi për Arsim Parashkollor” përfshin lëndë të karakteristike, teorike e praktike që kanë lidhje me profesionin e mësuesit të arsimit parashkollor, duke respektuar peshën specifike të secilit komponent me qëllim formimin e bazave të mësuesit të arsimit parashkollor, të cilat i japin mundësi studentit për zhvillimin e aftësive profesionale.</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula Bsc. Mesuesi per arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se lëndë të cilat krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale e komunikimit e ndërveprimit janë të përfshira në kurrikulën e programit, si: Aplikim kompjuteri, gjuhë e huaj.</p>

<p>sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Gjithashtu nga takimet me studentë gjatë vizitës 2 ditore rezulton se studentët punojnë në grup për detyra kursi duke iu krijuar kështu mundësia për komunikim e ndërveprim me njëri tjetrin dhe pedagogun e lëndës.</p> <p>Evidenca II.1 Kurrikula Bsc. Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes realizon analiza semestrale dhe në lidhje me realizimin e qëllimeve lëndës. programi realizohet në 80-85% të tij, për shkak të festave zyrtare.</p> <p>Të shihet mundësia e zëvendësimit të orëve, sepse nuk mund të flitet për realizim të objektivave nëse orët mësimore nuk zhvillohen në totalin e tyre të planifikuar. Secili nga pedagogët e lëndës zhvillon në fund të periudhës orë përsëritje, të pasqyruara këto dhe në syllabyse, orë në të cilat realizohet dhe orientimi i studentëve për çështjet më të rëndësishme dhe detyrimet përmbyllëse, e konstatuar kjo dhe gjatë takimeve të zhvilluar me stafin dhe studentët, gjatë vizitës 2 ditore në institucion.</p> <p>Evidenca III.13 Raport semestral departamenti v.a. 2022-2023.pdf</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti III.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e</p>	<p>Në syllabysset e paraqitura evidentohet që në pjesën më të madhe të seminareve, organizimi i mësimit realizohet nëpërmjet diskutimit. Në takimet me studentët dhe stafin, gjatë vizitës dy ditore në Institucion, u konstatua që stafi akademik, i angazhuar në këtë program, krijon një klimë të përshtatshme për diskutimin e ideve dhe i përfshin studentët në veprimtari kërkimore shkencore, botime, etj. Stafi dhe studentët e këtij programi kanë zhvilluar mobilitete në institucione të njëjta, duke bërë të mundur shkëmbimin e përvojave.</p> <p>Evidenca Shënime gjatë vizitës dyditore në institucion.</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti I.pdf</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti II.pdf</p> <p>Evidenca II.6.a Syllabyse Viti III.pdf</p>

shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Evidenca R.II, R.III, R.IV, R.V – mobiliteti i stafit dhe studenteve.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik që mbulon këtë program është i angazhuar në veprimtari të cilat synojnë të përditësojnë stafin dhe studentët mbi të rejat në fushën e teknologjisë. Veprimtari të tilla si: leksion i hapur, tryezë e rrumbullakët, zhvillohen në mënyrë sistematike. Gjithashtu DEA përfshin në këto veprimtari dhe ekspertë të huaj që kanë lidhje me fushën e edukimit, si, p.sh: Ora e hapur “Education for all”, nga Thomas Schrei. Evidenca III.8 Leksion i hapur Education for all.pdf Evidenca III.1 Lista e aktiviteteve shkencore 2029-2023.pdf			
Konkluzione	<i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, si njësi përgjegjëse për Programin e studimit Bsc. Mësuesi për arsimin parashkollor, është i përkushtuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies Në punën e tij stafi akademik i angazhuar në këtë program krijon hapësira e mundësi për zhvillimin e aftësive sociale e teknologjike të studentëve dhe njohjen e tyre me informacionet me relevante në lidhje me profesionin e tyre. Organizimi i veprimtarive në auditor dhe jashtë auditorit tregojnë që stafi është i angazhuar në formimin e zhvillimin e kompetencave të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit	Rezulton se të gjitha kriteret e vlerësimit, pragu i mesatares për punim diploma, provim përfundimtar janë të përcaktuara në Nenin 24 dhe Nenin 29 të rregullores së programit. Studentët me mesatare mbi 8.7 kanë të drejtë për punim diplome. Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mësuesi për Arsim parashkollor. Pdf

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Ëch site: ë ë ë.ascal.al

<p>të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Detyrimet përmbyllëse janë të pasqyruara në Rregulloren e Programit. Studentët njihen me këto detyrime në javën orientuese. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, nëpërmjet personelit akademik efektiv, organizon seanca orientuese, me qëllim sqarimin dhe udhëzimin e studentëve që do të zhvillojnë provimin e formimit, duke u mbështetur në fondin e përgjithshëm të pyetjeve. Studentët të cilët do të mbrojnë temë diplome kanë të drejtë që të përcaktojnë vetë temën që do të trajtojnë në punimin e diplomës. Rregulla më të hollësishme për të gjithë procesin e përmendur më sipër jepen në Manualin e posaçëm për punimin e temës së diplomës.</p> <p>Evidenca II.2 Rregullore e programit Bsc Mesuesi për Arsim parashkollor. Pdf</p> <p>Evidenca III.12 Axhenda e javës orientuese.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Duke u bazuar në njohuritë e marra gjatë tre viteve akademike, hartohet një bankë pyetjesh, e cila u jepet studentëve paraprakisht. Komisioni zgjedh pyetjet për provim dhe përcakton peshën specifike të secilës pyetje. Neni 23 Rregullore e departamentit.</p> <p>Evidenca II.3 Rregullore Departamenti i edukimit dhe Anglishtes.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Në manualin e Punimit të temës së diplomës – evidenca III.15 përcaktohen qartë formati, struktura, kriteret teknike e roli i pedagogut udhëheqës. Gjithashtu pedagogu udhëheqës bën vlerësime të cilat paraqiten pranë departamentit. (evidence III.16)</p> <p>Evidenca III.15 Manual i punimit te diplomes.pdf</p> <p>Evidenca III.16 Formulari i udheheqesit te temes se diplomes.pdf</p>




rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia Bazë vë në dispozicion të studentëve bibliotekën dhe stafin ndihmës, si dhe i asiston ato në kryerjen e analizës së të dhënave. Nga takimet me studentët dhe stafin, gjatë vizitës dy ditore në institucion rezulton se pedagogët që mbulojnë këtë program ndjekin dhe mbështetin studentët e programit bsc Mësuesi për Arsimin parashkollor, si në detyrat e kursit, ashtu dhe në kërkimet që ata bëjnë për punimin e diplomës. Evidenca: Vizita dyditore në institucion. Shënime
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm ose të temës së diplomës, studenti vlerësohet me notë, kriteret e se cilës janë të përcaktuara në rregulloren e programit (neni 26, 29, 30 Kreu V) Evidenca II.2 Rregullore e Programit Bsc. Mesuesi per Arsimin parashkollor.pdf
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomes të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe sportit. Evidenca III.17.a Diploma.pdf Evidenca III.17. b Suplementi.pdf Evidenca III.17.c Lista e notave.pdf
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Informacionet e krijuara gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe administrative dokumentohen e arshivohen sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Rregulloren e sekretarisë. Sekretaria mësimore funksionon sipas rregullores. Në sekretarinë mësimore disponohen të gjithë të dhënat e studentëve. Çdo student mund të kërkojë në çdo kohë informacione që lidhen me jetën e tij akademike, brenda kufijve të caktuara në aktet rregullatore të universitetit, si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Evidenca III.18 Rregullore e sekretarisë mesimore.pdf
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë</i>

	<i>me dokumentacionin përkatës. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, ka hartuar rregullore, manual dhe formularë, të cilët janë të detyrueshëm për t'u përmbushur, si nga Pedagogu udhëheqës në lidhje me Detyrimet përmbyllesë, ashtu dhe për sekretarinë e shkollës, me qëllim pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm dhe informacionet që studenti kërkon.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Gjatë vizitave në institucion, si dhe bazuar në (Evidencë 81, tabelat 1, 2, 6.3 dhe 7), për vitin akademik 2022-2023, 2021-2022, 2020-2021 dhe vitin akademik 2019-2020 konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit ofron ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies. Sa më sipër:</p> <p>Në vitin akademik 2022-2023, kemi të angazhuar 22 personel akademik, nga të cilët 3 janë me titullin Prof. As., 13 janë me gradën Doktor, 1 me gradën ME dhe 5 janë Msc.</p> <p>Në vitin 2021-2022, kemi të angazhuar 23 personel akademik, nga të cilët 2 janë me titullin Prof. Dr., 2 janë me titullin Prof. As., 15 janë me gradën Doktor, 1 me gradën ME dhe 2 janë Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, janë angazhuar në total 20 personel akademik, nga të cilët 3 janë me titullin Prof. As., 12 janë me gradën Doktor, 1 me gradën ME dhe 4 janë Msc.</p>

	<p>Në vitin 2019-2020, kemi të angazhuar 21 personel akademik, nga të cilët 3 janë me titullin Prof. As., 14 janë me gradën Doktor, 1 me gradën ME dhe 2 janë Msc.</p> <p>Bazuar në të dhënat e mësipërme evidentohet plotësimi i kuadrit ligjor lidhur me ekspertizën dhe nivelin profesional në procesin mësimdhënës në një program të ciklit të dytë, gjithashtu, bazuar në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, pika 3/c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”, vërejmë se raporti PAE dhe PAK, është:</p> <p>Për v.a 2019-2020 është 15 PAE -7 PAK;</p> <p>Për v.a 2020-2021 është 12 PAE -8 PAK;</p> <p>Për v.a 2021-2022, është 14 PAE -9 PAK;</p> <p>Për v.a 2022-2023 është 12 PAE -10 PAK;</p> <p>Referuar orëve të zhvilluara në auditor, konstatojmë respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, por numri i lëndëve të zhvilluara nga personeli akademik, tejkalon numrin maksimal të disiplinave që mund të zhvillohen brenda një viti akademik, bazuar në Udhëzimin nr. 29, dt. 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p><i>Sa më sipër, rekomandojmë rishikimin e shpërndarjes të ngarkesës mësimore, bazuar në Udhëzimin nr. 29, dt. 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.</i></p> <p>(Evidencë 81)</p> <p>(Tabelat 1, 2, 6.3 dhe 7)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatuam se, bazuar në Evidencë Tabelat 12, 1, 12 6. dhe, personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konform Udhëzimit nr. VKM 418 dt. 10.05.2017, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, por jo në zbatim të Udhëzimit nr. 29, dt. 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e</p>

	<p>arsimit të lartë. Ngarkesa mesimore është 69% PAE dhe 31% PAK</p> <p><i>Sa më sipër, rekomandojmë rishikimin e shpërndarjes të ngarkesës mesimore, bazuar në VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mesimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe bazuar në takimin me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektesë në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mesimore. Zyra e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas</p>	<p>U konstatua se, Institucioni, ka punonjës ndihmës në realizimin e programit të studimit në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mesimore. Kontributi i tyre konsiston në ndihmën e dhënë pedagogëve dhe studentëve, në zhvillim të proceseve akademike.</p> <p>(Evidencë Tabela 1)</p>

natyrës specifike të programit të studimit.	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së AU, në lidhje me strukturën analitike të DEA, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>(Evidencë 79)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni “AU”, ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe ZVA dhe shkolla të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht, Institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA Tiranë, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor. AU merr përsipër: deklarin e studenteve praktikante lidhur me sigurimet shendetesore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës. ZVA, merr përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë.</p> <p>(Evidencë 1.8)</p> <p>(Evidencë IV.3)</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në</p>	<p>Realizimi i praktikave mesimore, zhvillohet sipas një protokolli të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Formularet dhe dosja e praktikës janë pjesë</p>

<p>realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>përbërëse e vlerësimit final të studentit, si dhe paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuar gjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>(Evidencë 1.8)</p> <p>(Evidencë IV.3)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit. Konstatuam gjithashtu, se Zyra e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, si dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program</i></p> <p><i>Konstatuam se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Raporti i ngarkesës mësimore të lektorëve të jashtëm me ngarkesën e lektorëve efektivë, respekton legjislacionin në fuqi, por numri i lëndëve të zhvilluara nga personeli akademik, tejkalon numrin maksimal të disiplinave që mund të zhvillohen brenda një viti akademik, bazuar në Udhëzimin nr. 29, dt. 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e

Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se, lëndët e programit, zhvillohen në kampusin universitar, si dhe

<p>mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mjaftueshme, lidhur me nevojën specifike të programit. Të gjitha auditorët janë të pajisura me mjetet specifike të mësimdhënies në këtë program studimi, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si praktike edhe teorike.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Konstatuam se, disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit, duke përmbushur kështu standardet e duhura për student.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga vizita e mjediseve, konstatuam se, auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj). Disa nga sallat e leksioneve, në të cilat zhvillohen lëndët e programit të studimit janë të pajisura me videoprojektorë. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatuam se, mjediset mësimore si zyra, salla leksionesh, laboratorë, sallë konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur</p>	<p>Rezulton se, disponohet një laborator pajisur me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik, i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet afërsisht 35 vendesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me</p>

me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të AU, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson, deri-diku, kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjëndet si fizikisht, duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit, si dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme. Gjatë vizitës në institucion konstatuam se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë; - Literatura ndihmëse; - Periodik të huaj; - Periodik shqiptarë; - Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve. <p>Por, në shqyrtimin e database të teksteve fizike, u vu re një mungesë e theksuar, lidhur me tekstet me karakter pedagogjik.</p>

	<p>U evidentuan vetëm dy tekste, të cilët, përmë tepër, i përkisnin viteve 2008 dhe 2013.</p> <p><i>Bazuar në nevojën specifike të programit të studimit, për tekste të azhurnuara, si dhe një numër më i madh i nevojshëm i teksteve me karakter pedagogjik, rekomandojmë rishikimin e detajuar të literaturës respektive dhe përshtatjen me nevojat e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatojmë se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>(Evidencë IV.6)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka është e konceptuar në një mjedis tërësisht të përshtatshëm, vendosur në katin e nëndheshëm me mungesë të ndriçimit natyral. Në bibliotekë, përtej teksteve fizike, gjenden edhe mjediset përkatëse përsa i përket mundësisë të shqyrtimit të literaturës, por nuk evidentuam asnjë formë biblioteke online e cila do t'i jepte studentëve dhe pedagogëve një mundësi përzgjedhjeje më të gjerë.</p> <p><i>Sa me sipër, rekomandojmë rishikimin e infrastrukturës fizike të bibliotekës, si dhe krijimin e mundësisë të bibliotekave online.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se, Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes të programit të studimit. Bazuar në vizitën në institucion, rezultoi se numri i teksteve përfshin libra teorik në gjuhën shqipe 178 tekste dhe në gjuhën angleze 110 tekste. (Evidencë IV.5)</p> <p>Por, në shqyrtimin e database të teksteve fizike, u vu re një mungesë e theksuar, lidhur me tekstet me karakter pedagogjik. U evidentuan vetëm dy tekste, të cilët, përmë tepër, i përkisnin viteve 2008 dhe 2013.</p> <p><i>Bazuar në nevojën specifike të programit të studimit, për tekste të azhurnuara, si dhe një numër më i madh i nevojshëm i teksteve me karakter pedagogjik, rekomandojmë rishikimin e detajuar të literaturës respektive dhe përshtatjen me nevojat e programit të studimit.</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatuam se, menaxhimi i librave të bibliotekës është i realizuar nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p>Rezulton se, kërkimi bëhet në katalogun manual dhe shërbehet në fondin e mbyllur për t’u studiuar në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 16:00. Por, mungesa e një raporti të regjistrimeve të studentëve e bën të pamundur marrjen e informacionit lidhur me numrin e frekuentuesve të bibliotekës.</p> <p>(Evidencë IV.3.2 & IV.3.5)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion, rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim në platformat on-line si Microsoft Teams, ku administrohen materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, materialet shtesë, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka, ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi, me kohë të mjaftueshme për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte, dhe 08:00-12:00 ditën e shtunë. Ky orar është dhe i afishuar në hyrje të bibliotekës. Por, për studentët nuk ka kartelë regjistrimi, gjë që e bën të pamundur marrjen e informacionit lidhur me numrin e frekuentuesve të bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të</p>	<p>Konstatohet se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit të studimit. Por, në shqyrtimin e database të teksteve fizike, u vu re një mungesë e theksuar, lidhur me tekstet me karakter pedagogjik. U evidentuan vetëm dy tekste, të cilët, përmë tepër, i përkisnin viteve 2008 dhe 2013.</p>



<p>studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p><i>Bazuar në nevojën specifike të programit të studimit, për tekste të azhurnuara, si dhe një numër më i madh i nevojshëm i teksteve me karakter pedagogjik, rekomandojmë rishikimin e detajuar të literaturës respektive dhe përshtatjen me nevojat e programit të studimit.</i></p> <p>(Evidencë IV.6)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka e AU ka një fond fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi specifik dedikuar kurseve me karakter pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të parë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë:</i></p> <p><i><u>Rekomandohet</u> shtimi i fondit të teksteve fizik dhe elektronik në fushën e edukimit (literature bazë dhe e këshillueshme) për plotësimin e nevojave të studentëve në realizimin e leksioneve, detyrave dhe projekteve të kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ky program studimi ofron për formimin e mësuesve të ardhshëm.</i></p> <p><i>Gjithashtu, mjedisi i bibliotekës është tërësisht i papërshtatshëm, vendosur në katin e nëndheshëm me mungesë të ndriçimit natyral. Sa më sipër, ky standard përmbushet pjesërisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi IV.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë</p>	<p>Konstatojmë se AU përdor sistemin digjital të brendshëm në përdorim për zhvillimin dhe administrimin e informacionit me</p>

<p>informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>studentët platformën e PITAGORA. Gjithashtu konstatuam që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik; • të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen.
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në Raportin Semestral të DEA rezulton se, institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik. (Evidencë III.13)</p> <p>Ndërsa në listën e marrëveshjeve, në funksion të programit të studimit shpehet qartë aktiviteti që institucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij program studimi siç janë: ZVA përkatëse si Tiranë, Durrës, Lushnje për zhvillimin e praktikave. Zyra e burimeve njerëzore disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa DEA monitoron dhe nxit aktiviteti mësimor dhe kërkimor-shkencor siç pasqyrohet edhe në Analizën Vjetore të Veprimtarisë së Njësisë Bazë. (Evidencë III.13)</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me sekretarinë mësimore konstatuam se, ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në PITAGORA dhe në formatin e Regjistrimit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrimit të Diplomimit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet</p>	<p>Nëpërmjet sistemit digjital PITAGORA rezulton se, institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me</p>

personelit akademik dhe studentëve.	studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nëpërmjet Planit Strategjik të Institucionit AU, (Evidencë I.2.a & 1.2.b) dhe Raportit Semestral të DEA, (Evidencë III.13), rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ në hedhjen në kohë të dokumentacionit të këkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe kriterëve të vlerësimit dhe respektimit të afateve të hedhjes së rezultateve në platformën PITAGORA.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konfirmojmë që në faqen zyrtare të internetit të AU janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendari akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UA, në tre gjuhë: shqipe, angleze dhe italiane.								
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit PITAGORA, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatojmë, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të këkuar, në faqen e tyre zyrtare të ëeb-it në gjuhën shqipe, angleze dhe atë italiane, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili miratohet nga Senati akademik dhe Bordi i Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit. (Evidencë 33/1).</p> <p>AU harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj. Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit të studimit burojnë nga tarifa e studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar të njësisë bazë. Ku specifikohen shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit.</p> <p>(Evidencë 33/1 & 33/2)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB rezulton se, procedura për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit afatmesëm fillojnë në gjysmën e dytë të vitit akademik, pasi janë marrë parasysh nevojat e njësive kryesore të institucionit.</p> <p>(Evidencë RVB)</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatohet se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 3 vite kalendarike dhe konstatohet se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përsa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.</p> <p>(Evidencë IV.8)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se AU, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program.</p> <p>(Evidencë tabela 18)</p>			
	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rezulton se, institucioni zbaton politika për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019 “Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë që, institucioni ka ngritur Zyrën e Transferimeve dhe Ekuivalentimit të Studimeve ku nëpërmjet Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. (Evidencë II.7)</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar</p> <p>2019-2020 15 studentë</p> <p>2020-2021 20 studentë</p> <p>2021-2022 27 studentë</p> <p>2022-2023 65 studentë</p> <p>Në fillim të vitit akademik DEA ngrë Komisionin Ad-hoc të Ekuivalentimeve dhe Transferimeve të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Konfirmojmë që, procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të</p>	<p>Konstatojmë se, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron AU, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online.</p>

<p>veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që AU ofron.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rezulton se, institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik AU, publikon online kriteret e pranimit, procedurat përkatëse si dhe mbarëvajtjen e studimeve për secilin program studimi. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/). Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të AU, gjendet, gjithashtu edhe informacioni i plotë i mundësive që kanë studentët lidhur me procedurat e pranimit, përzgjedhjes etj. https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/programet-studimi/), bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Konstatuam se, institucioni harton dhe bën publike të gjithë informacionin e nevojshëm, lidhur me kuotat, kriteret dhe specifikat programore, lidhur me aksesimin e programit të studimit, për të gjithë tipologjitë e kandidatëve të mundshëm, gjithashtu edhe të kandidatëve aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>(Evidencë V.2)</p>

<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Çdo vit, institucioni, bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe në aktet nënligjore respektive, bën publike duke shpallur dhe evidentuar qartësisht, kriteret, procedurat dhe mbarëvajtjen e përzgjedhjes së kandidatëve, për programin e studimit.</p> <p>(Evidencë V.2)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Konstatuam se, AU, ndjek një politikë të qartë lidhur me strategjinë e zhvillimit institucional, politikave shtetërore lidhur me shtresat në nevojë, duke nxjerrë në pah dhe evidentuar mbështetjen dhe promovimin e studentëve me arritje të shkëlqyera.</p> <p>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron AU, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online në faqen zyrtare të ëeb-it.</i></p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë se AU, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Konstatojmë që, programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të AU sipas fakulteteve përkatëse</p>

<p>përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-edukimit-dhe-anglishtes/)</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i Studentit ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e AU dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin; (Evidencë V.8) • Rregullorja e Programit të Studimit, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin; (Evidencë II.3) • Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit me karakter profesional; (Evidencë II.6.a.b.c) • Kurrikulën e Programit të Studimit; (Evidencë tabela 9) • Kalendarin akademik në të cilin përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet etj; <p>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendar-akademik/).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, (Evidencë II.3) dhe Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve studenti gjen informacion të plotë mbi regjistrimet dhe transferimet, kualifikimet etj. (Evidencë II.7)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë se, bazuar në Rregulloren e AU, (Evidencë I.3), në Manualin e Studentit (Evidencë V.8) dhe syllabuset (Evidencë II.6.a.b.c) e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi. (Evidencë II.3)</p> <p>Në fillim të semestrit të dytë, viti i tretë studentët u vihet në dispozicion Manuali për hartimin e temës së diplomës. (Evidencë III.15)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të ditëve të hapura për maturanët AU organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth AU dhe programeve të studimit që ai ofron.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion u informuam se institucioni në fillim të vitit të parë të studimeve DEA në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Gjithashtu studentëve i vihet në dispozicion broshura informuese dhe Manuali i Studentëve. (Evidencë V.8)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban program i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit të vitit akademik, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e AU dhe funksionin e tyre si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet që, nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. (Evidencë V.8)</p> <p>Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Microsoft Teams. Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Rezultoni se, në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale udhëzuese si Manuali i Studentit, (Evidencë V.8), dhe Rregullorja e Programit të Studimit, (Evidencë II.2), përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në Strukturën e Vitit Akademik dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të AU.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se, Zyra Karrierës dhe Alumnit informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale tregut të punës. (Evidencë V.7)</p> <p>Nëpërmjet Udhëzuesit për Zhvillimin e Karrierës studentët orientohen për zgjedhjen e karrirës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës. (Evidencë V.9)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Çdo fillim të vitit të parë të studimeve DEA organizon një takim informues me studentët e rinj gjatë së cilës orientoheshin me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</p> <p>Gjithashtu Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së studentëve (ZKMS) ka si mision orientimin dhe këshillimin e studentëve për zhvillimin profesional dhe personal. (Evidencë V.6)</p> <p>Në faqen e internetit të AU gjithashtu gjendet i publikuar “Manuali i studentëve” ku studenti mund të gjejë informacion të plotë për strukturat e AU dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.</p>

<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Konstatohet se, nëpërmjet sistemit digjital PITAGORA institucioni menaxhon dhe administron rezultatet e studentëve. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë, nëpërmjet ëëbsite: (https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik/).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton që faqen e internetit të AU, gjithashtu gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e AU dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët.</i></p> <p><i>Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme artistike që institucioni organizon. Rezulton se në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit, e cila përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit dhe Plani strategjik për zhvillimin e insitucionit, konstatojmë se institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer.</p> <p>Konstatohet, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që AU ofron, specifiku për programin e studimit, rezultojnë të diplomuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2019-2020 në total 15 studentë; • për vitin akademik 2020-2021 në total 20 studentë; • për vitin akademik 2021-2022 në total 27 studentë;

	<ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2022-2023 në total 65 studentë; (Evidencë tabela 23)
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, rezulton se Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore, konstatuam se, ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se, sekretaria mësimore e FSHSH disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit. Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në platformën digjitale PITAGORA.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazur ne Rregulloren e funksionimit të Sekretarisë Mësimore, si dhe në Rregullorja e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni të AU, rezulton se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njëjësive përgjegjëse si sekretaritë mësimore, sektoret e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>(Evidencë III.18 & IV.6)</p>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Konstatojmë se, institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse, si më poshtë:</p> <p>Për vitin 2019-2020, mesatarja në hyrje ka qenë 7.5 në dalje 7.6,</p> <p>Për vitin 2020-2021, mesatarja në hyrje ka qenë 8.02 në dalje 7.7,;</p> <p>Për vitin 2021-2022, mesatarja në hyrje ka qenë 7.9 në dalje 7.3,</p> <p>Për vitin 2022-2023, mesatarja në hyrje ka qenë 7.46 dhe në dalje 7.8;</p> <p>(Evidencë tabela 21) (Evidencë Dok. Shtesë 2)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e</p>	<p>Konstatojmë që, studentët e AU janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit:</p> <p>Ata kanë përfaqesues në:</p> <p>- Senatin Akademik</p>



<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>- Në Këshillin e Etikës, bazuar në RVB</p> <p>- Grupin e ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit.</p> <p>(Evidencë I.1.a)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Rezulton që, institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu një nga strukturat e ngritura në AU është edhe Këshilli i Studentëve i cili funksionon në bazë të rregullores përkatëse.</p> <p>(Evidencë I.1.a)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Konstatohet se, studentët janë të përfshirë në komisionet e ngritura nga NJSBC që kanë për detyrë të monitorojnë cilësinë e zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit si dhe të mbështesin punën e njësive bazë për akreditimin, hartimin e programeve të reja të studimit etj. si dhe janë pjesë e GVB për hartimin e RVB për programin e studimit.</p> <p>(Evidencë VI.9)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e procesit mësimor, nga stafi akademik, focus grupeve dhe pyetësorëve për studentët, studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.</p> <p>(Evidencë III.9 & III.10)</p>

njesisë/pedagogut përgjegjës.	
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë që studentët e AU janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të insitucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm dhe u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës. Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Konstatojmë se, institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet dhe ZKMS dhe ZKA, si dhe zyrave përkatëse si sekretaria mësimore dhe sekretariatë e departamenteve. Gjithashtu jashtë çdo departamenti ekziston këndi i informimit dhe njoftimeve që departamenti përkatës afishon. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohen në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manuali i Studentit. (Evidencë V.8)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve	Konstatojmë që, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të AU studentët kanë mundësi të informohen edhe në distancë për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave online, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, studentët mund të gjejnë në Microsoft Teams, ku



<p>dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>mund të informohen për zhvillimin e leksioneve, detyrat e kursit, provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se, nëpërmjet ZKMS (Evidencë I.9.a & I.9.b) kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studentëve që institucioni organizon.</p> <p>Nëpërmjet Manualit të Studentit, (Evidencë V.8), studentët orientohen në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione, shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin koordinatorit të programit. (Evidencë IV.3)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Konstatohet që, ZKA gjurmon studentët pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. Kjo, u evidentua edhe në takimet e kryera me studentët, pedagoget, si dhe duke u bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar.</p> <p>(Evidencë V.11)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatohet që studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, që institucioni organizon. Për sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Njësia bazë, ka hartuar Rregulloren e Departamentit, Planin strategjik të departamentit, si dhe Rregulloren e programit të studimit, ku jepen direktiva të qarta për zhvillimin e kurrikulës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore që duhen përdorur në procesin mësimor. Ato orientojnë për punën që duhet bërë në lidhje me hartimin e sylabuseve lëndore, përzgjedhjen e literaturës, metodat bashkëkohore, sistemin e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin, etj.</p> <p>Evidencë (I.4)</p> <p>Evidencë (II.3)</p> <p>Evidencë (II.2)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatuam se, institucioni ka ngritur një komision për monitorimin dhe sigurim e cilësisë në AU. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe të programeve të studimit dhe të marrëdhënieve me strukturat e tjera brenda universitetit. Disa forma që institucioni përdor për vlerësimin e performancës së universitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik;



	<ul style="list-style-type: none"> - Raporti vjetor i punës mësimore-shkencore i stafit akademik; - Analiza vjetore të punës: - Vlerësimi i mësimdhënies nga studentet. <p>Evidencë (III.1)</p> <p>Evidencë (III.9 & III.10)</p> <p>Evidencë (VI.9)</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>ZSBC është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që i drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre. Gjithashtu, institucioni kryen edhe raporte vetvlerësuese lidhur me personelin akademik. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të AU.</p> <p>(Evidencë III.9)</p> <p>Evidencë III.1.1)</p>				
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë është përgjegjëse për realizimin e pyetësorëve të studentëve, focus grupeve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, duke vënë në dijeni stafin drejtues dhe personelin akademik.</p> <p>(Evidencë VI.9)</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit, nuk shërbejnë si penalitete, por si modele që duhen përmirësuar dhe nxitur në mënyrë konstruktive. Ato i shërbejnë institucionit, departamenteve dhe vetë pedagogëve për të qenë më aktivë në planet e zhvillimit strategjik të institucionit, programit të studimit dhe lëndëve të veçanta.</p> <p>Evidencë (III.9 & III.10)</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka ngritur një zyrë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në AU, dhe se ZSBC organizon pyetësorët dhe focus grupet me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se institucioni ka hartuar politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në AU bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Institucioni ka ngritur një zyrë për Sigurimin e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes kësaj zyre. Nga vizita në institucion dhe bazuar në organigramën e AU, rezulton se, institucioni ka në strukturë të tijë njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Evidencë (VI.10 & VI.9)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Konstatojmë që, institucioni ka ngritur një Zyrë për Sigurimit e Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.</p> <p>(Evidencë VI.9)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe</p>	<p>Konstatojmë që, institucioni përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësor për studentët dhe focus grupe për matjen e cilësisë së procesit mësimor. Gjithashtu rezulton se institucioni vlerësohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional, raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton.</p> <p>Evidencë (III.9 & III.10)</p>



proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.							
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Konstatohet që, institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes si dhe arritjeve përmes sondazheve dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional si dhe në nivel njësie bazë për punën mësimore-shkencore të stafit akademik. (Evidencë I.12)						
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Zyrës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo zyrë, në mënyrë periodike aplikon metoda të ndryshme për matjen e cilësisë si dhe të politikave të tjera të burimeve akademike. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i	Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që institucioni ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë

<p>shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>kërkimore shkencore dhe mësimore, duke analizuar faktoret e riskut për çdo kategori.</p> <p>(Evidencë 79)</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit Strategjik të AU dhe Raporti vjetor i punës mësimore-shkencore i stafit akademik të DEA, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën e indikatorëve, objektivave dhe qëllimeve, ku trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p>(Evidencë I.1.b)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të</p>	<p>Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët; • Focus grupe me studentët; • Raportin e Vlerësimit të Programit të Studimit; • Raportin vjetor të punës mësimore-shkencore i stafit akademik të DEA; • Statistika të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik. <p>(Evidencë III.9 & III.10)</p> <p>(Evidencë III.1)</p>



standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Për vlerësimin stafit akademik nga studentët; 2) Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxëniet nga studentët; 3) Analizë e aktiviteteve të përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve; 4) Dosja e aktiviteteve shkencore të pedagogëve. <p>(Evidencë III.9 & III.10) (Evidencë III.1)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpërhershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Është site: e e e.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rezulton që, nëpërmjet analizës SËOT dhe Raportit Vjetor të DEA (Evidencë I.12), si dhe plani i vetëvlerësimit të programit të studimit (Evidencë 79), institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rezulton se, institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave, si dhe i evidenton ato nëpërmjet dokumentacionit të dërguar. Gjithashtu, ky informacion u siguroi edhe nëpërmjet takimeve respektive, me të gjitha grupet e interesit. (Evidencë 79)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Rezulton se, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, sic pasqyrohet edhe në grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. (Evidencë H.1)</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Mbarëvajtjes së Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në AU, si dhe Kodit të Etikës, (Evidencë VI.6 & VI.10), takimeve respektive dhe shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm, rezulton se, institucioni</p>

të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve, duke marrë masa lidhur me ndonjë problematikë të mundshme, bazuar në rregulloren përkatëse.								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Rezulton se, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që AU ka me institucione të rëndësishme si me Universitetin e Vienë-s është arritur realizimi i ndryshimeve të cilësisë së programit të studimit. (Evidencë I.7) Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me ZVA Tiranë, Durrës dhe Lushnje për realizimin e praktikave profesionale luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. (Evidencë I.8)								
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	Rezulton se, institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen

<p>programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>zyrtare të AU. (https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Raporin Vjetor të AU dhe Raportin Vjetor në rang njësie bazë, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. (Evidencë VI.11) (Evidencë I.12),</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Konstatojmë se, në Planin Strategjik të AU është hartuar analiza për sigurimin e cilësisë e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Kjo u evidentua edhe në takimet në institucion me grupet e interesit. (Evidencë I.1.b)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se, institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e NJSBC, miratur nga Senati Akademik në vitin 2017. (Evidencë VI.9)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me NJSBC rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie baze, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret</i></p>

	<i>ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tcl:+355 (04) 222-43423

Ëmb site: [e e.ascal.al](http://e.e.ascal.al)

E-mail: info@ascal.al



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për arsimin parashkollor” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Zbatimi i legjislacionit në fuqi për funksionimin e programit.
2. Stafi i përkushtuar dhe transparenca në marrëdhënie me studentët
3. Organizimi dhe drejtimi i punës në departament.
4. Mjediset dhe vendndodhja e Fakultetit

Pika të dobëta:

1. Bashkërendimi i punëve nëpërmjet strukturave të ngritura në Fakultet për përmirësimin e cilësisë(Standardi 1 Kriteri 4)
2. Angazhim i specialistëve në fushën e edukimit për hartimin e zhvillimin e kurrikulës në bazë fakulteti. (Standardi II 1 kriteri 2)
3. Puna për zhvillimin e brendshëm profesional të stafit.(Standardi IV1 Kriteri1)
4. Numri i paktë i librave që lidhen me fushën e edukimit në bibliotekë.(Standardi IV3 Kriteri 8)

Rekomandime:

1. Rishikim i syllabyseve për sa i përket literaturës, metodave të mësimdhënies, përmbajtjes dhe pasqyrit të rezultateve mwsimore,
 2. Rishikimi i planit mësimor (kurrikulës) në lidhje me lëndët duke u fokusuar në formimin pedagogjik të studentëve.
 3. Pasqyrimi i planeve te veprimit për përmirësimin e cilësisë, si dokumentimi i gjetjeve nga instrumentat e përdorur dhe grupet e interesit në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve.
-
4. Zbatimi i Udhëzimi 29, datë 10.09,2018, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e arsimit të Lartë.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Preeschool Education Teacher" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and Affirmations:

1. Implementation of the legislation in force for the operation of the program.
2. Dedicated staff and transparency in relations with students.
3. Organization and direction of work in the department.
4. Facilities and location of the faculty.

Weak points:

1. Coordination of work through the structures set up in the faculty for quality improvement.
2. Engagement of specialists in the field of education for the design and development of the curriculum at the faculty.
3. Work for the internal professional development of the staff.
4. Small number of books related to the field of education in the library.

Recommendations:

1. Revision of syllabi in terms of literature, teaching methods, content, and reflection of learning outcomes.
2. Revision of the teaching plan (curriculum) in relation to the subjects, focusing on the pedagogic formation of the students.
3. Review of action plans for quality improvement, such as documenting the findings from the instruments used and interest groups in order to improve the quality of the programs.
4. Implementation of Instruction Number 29 dated 10.09.2018, by the Ministry of Education, Sports, and Youth, for the activity and teaching load of academic staff in higher education institutions.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

